REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:158845

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05626865

**P.nr. 59/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA NË KLINË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM** Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Sabrije Raci, me bashkëpunëtoren profesionale Albulena Morina-Lulaj, në çështjen penale kundër të pandehurve: B (P) L, dhe Xh (N) L që të dy nga fshati D,K K, për shkak të veprës penale ‘’Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme’’ nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II-nr. 1470/2021, të datës 05.08.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 27.03.2024 në praninë e Prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Ramiz Buzhala, të pandehurit B. L dhe mbrojtësi av.Kaltrina Shala dhe Xh.L, mbrojtësi i tij av. Miranda Avdyli ndërsa me datë 26.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T GJ Y K I M**

**Të pandehurit:**

1. **B (P) L** i lindur me dt..... në fshatin D, K. K, me vendbanim në fshatin D K K, nga i ati P, e ëma T, me mbiemrin e vajzërisë P, ka të kryer fakultetin e kulturës fizike, i martuar, baba i 5 fëmijëve, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ..... i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

2. **Xh (N) L,** i lindur me dt ..... në fsh.D, K.K, me vendbanim në fshatin D, K. K, nga i ati N, e ëma T, me mbiemrin e vajzërisë B, ka te kryer shkollën fillore, i martuar, me profesion bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr..... i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

2024:090478

**JANË FAJTOR**

**I pandehuri B.L**

**Për shkak se:**

Në kohë të panjohur e në vazhdimësi gjerë me datë ....., në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të personit tjetër dhe atë të dëmtuarës Komunës së Klinës, në atë mënyrë që, i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme, pa asnjë bazë ligjore, në kohë të panjohur uzurpon pronën shoqërore të Komunës së Klinës me nr. P..... në sipërfaqe prej 1318 m2, në fshatin D. K.K, e të njëjtën pronë e shfrytëzon për ndërtimin e një objekti (sallon, ahur dhe garazh),

-me çka ka kryer vepër penale_*"Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme"* nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

**I pandehuri Xh . L**

**Për shkak se:**

Në kohë të panjohur e në vazhdimësi gjerë me datë ....., në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të personit tjetër dhe atë të dëmtuarës Komunës së Klinës, në atë mënyrë që, i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme, pa asnjë bazë ligjore, në kohë të panjohur uzurpon pronën shoqërore të Komunës së Klinës me nr. P....., në sipërfaqe prej 12641 m2, në fshatin D. K. K, e të njëjtën pronë e shfrytëzon për ndërtimin e shtëpisë.

-me çka ka kryer vepër penale_*"Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme"* nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata ne kuptim te nenit nenit 7,8,9,10,17,38,39,40,42,46,47,48,49,50,69,70 dhe neni 184 par1 dhe 185 par 2 lidhur me par 1 nen par 1.4 të KPRK-së si dhe nenit 365,369,450 te KPPRK-së të pandehurit i:

**GJYKON**

Të pandehurit:

**I.** Ashtu që të akuzuarit B. L i shqiptohet **dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet**, nëse i akuzuari brenda



2024:090478

periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

**II.** Xh. L, i shqiptohet **dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet**, nëse i akuzuari brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Nëse të akuzuarit e lartcekur, brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryejnë vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 par.1 dhe 3 të KPRK-së, do t'u revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të shqiptohet dënimi unik me burgim për veprën penale të kryer më parë dhe veprën penale të re.

III. **OBLIGOHEN**: Të akuzuarit B . L, pronën me nr. P-....., me sipërfaqe prej 1318m2 dhe i akuzuari Xh.L, pronën me nr. P....., me sipërfaqe prej 12641 me2, menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ti lirojnë pronat e uzurpuara në afat prej tre (tre) muaj.

IV.Detyrohen te pandehurit, qe secili veç e veç ti paguaj shpenzimet procedurale, qe ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen nga 20 (njëzet) euro, si dhe ne emër te taksës për kompensimin e viktimave te krimit të paguajnë secili nga 20 (njëzet) euro, te gjitha këto ne afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

V. Udhëzohet: P. K.K, qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

**A r s y e t i m**

*Ecuria e procedurës penale*

Prokuroria Themelore ne Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritë aktakuzën PP/II nr. 1470/2021 e datës 05.08.2022, kundër të pandehurve V.G nga Klina, për shkak të veprës penale ''Ndërtim pa leje'', nga neni 359 par 3 lidhur me par 2 të LPRK-së, dhe për veprën penale ''Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme'', nga neni 320 par 1 të KPRK-së, dhe të pandehurve B. L dhe Xh. L që të dy nga fshati , K. K, për shkak të veprës penale ''Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme'', nga neni 320 par 1 të KPRK-së.



2024:090478

Gjykata me aktvendimin me nr. P.nr. 177/22, të datës 21.03.2024, e ka veçuar procedurën për të pandehurit B. L dhe Gj. L, ndaj të cilëve është vazhduar procedura dhe është marrë numër i ri i lëndës, ndërsa për të pandehurin V. G, është përfunduar procedura pasi e njëjta e ka pranuar fajësinë, dhe i cili do të mbetet me numër të vjetër të lëndës.

Gjykata me datën 27.03.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të pandehurit B L, Xh. L, dhe mbrojtëset e të pandehurve Av. Kaltrina Shala dhe Av. Miranda Avdyli i tij Av. Shaban Shala, ku janë njoftuar për të drejtat e tyre në këtë çështje penale, ju është lexuar akuza, ku të njëjtit kanë deklaruar se e kanë kuptuar akuzën dhe nuk kanë nevojë për ndonjë sqarim.

I pandehuri B. L është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale në aktakuzë që i vihet në barrë, i vjen shumë keq për këtë rast është i penduar thellë për veprën që e kam kryer, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do ta përsërit një të tillë apo të ngjashme penale, dhe se është i gatshme ta lëshoj pronën nëse i kërkohet.

I pandehuri Xh. L është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale në aktakuzë që i vihet në barrë, i vjen shumë keq për këtë rast është i penduar thellë për veprën që e kam kryer, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do ta përsërit një të tillë apo të ngjashme penale, dhe se është i gatshme ta lëshoj pronën nëse i kërkohet.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit deklaron: pasi qe te pandehurit B L, dhe Xh. L e pranuan fajësinë që i vihet në barrë, dhe ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetare dhe pa presion duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës. i ka propozuar gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë nga e të pandehurve për veprën penale që ju vihet në barrë, dhe në rastin marrjes së vendimit lidhur ne dënimin, pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësja e te pandehurit B. L, Av Kaltrina Shala, lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj deklaron pas konsultimit te mjaftueshëm me te mbrojturin e saj, i njëjti në mënyrë vullnetare beri pranimin e fajësisë i vetëdijshëm për pasojat e pranimit te fajësisë andaj gjykatës i propozon qe me rastin e marrjes se vendimit ti merr parasysh rrethanat lehtësuese si faktin qe i njëjti nuk e ka dite me pare qe prona për te cilën akuzohet është në pronësi te komunës, po ashtu te merr



2024:090478

parasysh pranimin e fajësisë si dhe çdo rrethane tjetër lehtësuese qe do ta vlerëson gjykata, po ashtu faktin se për të njëjtin është hera pare qe bie ndesh me ligjin si dhe asnjëherë nuk ka qene i dënuar, dhe se i njëjti po ashtu është pensioner.

Mbrojtësja e te pandehurit Xh. L, Av Miranda Avdyli lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj deklaron pas konsultimit te mjaftueshëm me te mbrojturin saj, shpjegimit te pasojave dhe benifiteve te pranimit te fajësie pasi që i njëjti i ka kuptuar dhe pasi që u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet si mbrojtës e mbështet pranimin e fajësisë dhe i propozojnë gjykatës te njëjtën ta aprovoje ndërsa me rastin e vendosjes të ketë parasysh si rrethane lehtësues pranimin sinqertë dhe pa presion pranimin e fajësisë i njëjti shtëpinë ka ndërtuar duke menduar se është ne pronën tij nuk ka pas njohuri është pronën komunale, gjithashtu si rrethane lehtësues te merret qe i njëjti nuk ka ra asnjëherë ne ndesh me ligjin, gjithashtu edhe gjendja ekonomike financiare i njëjti është i papunë, andaj gjykatës i propozon sipas dispozitave ligjore te KPPRK-se dhe KPRK-se ti shqiptoj një dënim sa me te bute ngase edhe me shqiptimit të dënimit të tille mund te arrihet qëllimi i dënimit.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurve B. L dhe Xh. L, i vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të tyre, pasi që e me parë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të përgjegjësisë dhe të fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet ne këto prova, siç janë Raporti i Policor, punuar nga Rr. M. M, datë 16.04.2021, Raporti Policor, datë 14.05.2021, Raport informues, nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi e Pronësi, nr. Ref....., datë 28.06.2022, Procesverbal nga Drejtoria e Inspeksionit, datës 01.03.2021, për ndërprerje të punimeve për të paraqiturin V. G, Certifikata e pronësisë të dhënat për Njësinë Kadastrale P..... e evidentuar në emër të Komuna Klinë, kulturë kullosë e klasit III, zona Kadastrale Doberdol, Foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes ku shihet mënyra e kryerjes së këtyre veprave penale si dhe objektet e ndërtuara, Deklarata e të pandehurit V (P)G, e dhënë në Prokurorinë Themelore në Pejë me datë 21.07.2022, Deklarata e të pandehurit B(P)L, e dhënë në Prokurorinë Themelore në Pejë me datë 21.07.2022, Deklarata e të pandehurit Xh(N)L**,** e dhënë në Prokurorinë Themelore në Pejë me datë 21.07.2022.



2024:090478

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e përgjegjësisë dhe të fajësisë nga ana e të pandehurave është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit B. L dhe të pandehurit Xh. L, dhe janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3, të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për te pandehurin B. L gjykata mori pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga të pandehurit, me parë nuk kanë qenë të dënuara për ndonjë vepër tjetër penale, dhe i njëjti është i pensionuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk ka gjetur.

Ndërsa si rrethana lehtësuese për të pandehurin Xh. L, gjykata mori pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga të pandehurit, ëme parë nuk kanë qenë të dënuara për ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk ka gjetur.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve B. L dhe Xh. L, dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Duke gjetur se ky dënim është dënim adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurave dhe se me këtë dënim ndaj tyre do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurave nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.
Konform nenit 449 par. 1dhe par. 2, nën par 2.9 dhe nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, gjykata ka obliguar të pandehurit secilin veç e veç në pagesën e taksës në shumë prej 20 (njëzet) euro.

Konform nenit 449 par.1 dhe 2, nënpar.2.6, të KPPRK-se, gjykata ka obliguar të pandehurin që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro.



2024:090478

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 365 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.59/24 me datë. 26.04.2024

Gjyqtarja Gjykuese:
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.



2024:090478